

COMPOSITION IN KADARE'S WORK

KOMPOZIMI NË VEPRËN E KADARESË

Luljeta ADILI-ÇELIKU¹¹* Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology „Blazhe Koneski“, University „Saint Cyril and Methodius“ Skopje

*Corresponding author e-mail: l.adili@flf.ukim.edu.mk

Abstract

When you pick up the work of the colossus of letters to read, you get lost in the mastery of writing, in the beauty of the words he selects, in the greatness of the words he created. For more than eight decades on earth, he created works and left thoughts with high values for the Albanian nation, language and culture. We who lived in his time had the great fortune to be witnesses to what we saw and read and what our world-famous writer left us forever. Kadare's work is a separate institution, it is a treasure, it is a national asset. In this text, a small part of the composites created and found in the work of Ismail Kadare have been collected and analyzed from the aspect of word formation. He enriched the literary language and set high standards for it and for Albanian literature, raised it and ranked it at the highest level, equaling it with world literature and the Albanian language, giving it hundreds of new words.

It is difficult to write about Kadare in the past tense, because we grew up with his work and with him, following him in newspapers and on television. We are used to waiting for what new work we will read from him, what title he gave it, what topic he addressed, how many new words he created, how many dialectal and regional words he revived, and so on. But our writer left us many words to have among us worldwide. As we mentioned above, this paper analyzes the composites created by Ismail Kadare, collected in some of his works. This text is divided into two parts. In one part, Kadare's words are viewed from the aspect of the formation of compound words, from what type of composite they are, adverbial or determinative. Then, in the second part, these composites are divided into what grammatical category they are, into nouns with determinative or adverbial relations, into nodular and indeclinable adjectives, and so on. The paper uses an analytical method. Some of Kadare's most representative works have been read and analyzed, trying to collect the composites that were thought to have been created by him himself.

Keywords: Kadare, composite, analysis, adverbial, determinative.

Përmbledhje

Kur merr në dorë për ta lexuar veprën e kolosit të letrave, humb në mjeshtërinë e shkrimit, në bukurinë e fjalëve që përzgjedh, në madhësinë e fjalëve që i krijoi. Më shumë se tetë dekada mbi tokë, krijoi vepra të bukura letrare e la mendime me vlera të larta për kombin, gjuhën dhe kulturën shqiptare. Ne që jetuam në kohën e tij, patëm fatin e madh të jemi dëshmitarë për atë që pamë e lexuam dhe atë që na la përjetësisht si trashëgimi, shkrimtari ynë me famë botërore. Vepra e Kadaresë është institucion më vete, është thesar, është pasuri kombëtare. Në këtë tekst është mbledhur dhe analizuar nga aspekti i fjalëformimit një pjesë e shumë vogël e kompozitave të krijuara e të gjetura në veprën e Ismail Kadaresë. Ai e pasuroi gjuhën letrare dhe vuri standarde të larta për të dhe për letërsinë shqipe, e ngriti atë dhe e rangoi në shkallën më të lartë duke e barazuar me letërsinë botërore e gjuhës shqipe duke i dhënë qindra fjalë të reja.

E vështirë të shkruash për Kadarenë në kohën e shkuar, se jemi rritur me veprën e tij dhe me të duke e ndjekur në gazeta e në televizione. Jemi mësuar që të presim se çfarë vepre më të re do të lexojmë nga ai, çfarë titulli i ka vënë, çfarë teme ka trajtuar, sa fjalë të reja ka krijuar, sa fjalë dialektore e krahinore ka ringjallur, e kështu me radhë. Por, shkrimtari ynë na la shumë fjalë që ta kemi në mesin tonë përbotësisht. Siç përmendëm dhe me lartë, në këtë punim janë analizuar kompozitat e krijuara nga Ismail Kadare të mbledhura në disa nga veprat e tij. Përveç hyrjes dhe pjesës teorike që përmban, ky tekst është ndarë në dy pjesë.

Në njërin pjesë janë analizuar fjalët e përbëra kadareane nga aspekti i formimit të tyre parë nga ajo se çfarë lloji kompozitash janë, me marrëdhënie këpujore apo përcaktore, kurse në pjesën e dytë këto kompozita

janë ndarë në atë se çfarë kategorie gramatikore janë. Fjalët janë të gupuara në emra me marrëdhënie përcaktore apo këpujore, në mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm, e kështu me radhë. Në punim është përdorur metoda analitike. Janë lexuar disa nga veprat më përfaqësuese të Kadaresë dhe janë analizuar ata duke u përpjekur që të mblidhen kompozitat që mendohej se janë krijuar nga vetë ai.

Fjalët çelës: Kadare, kompozita, analizë, këpujore, përcaktore.

Hyrje

Gjuhët pasurohen dhe pastrohen me krijimi e fjalëve të reja dhe heqjen e fjalëve të huaja nga fjalori. Këtë punë e ka bërë Kadareja gjatë gjithë jetës së tij, traditë të trashëguar që nga Buzuku e Budi, nga rilindasit Naimi e De Rada, nga realistet Fishta e Migjeni, nga modernistët, Lasgushi e shumë të tjerë me radhë. Krijoi shumë fjalë të reja, ringjalli fjalë dialektore e krahinore dhe u përpoq që ta pastrojë gjuhën shqipe nga fjalë të huaja duke i zëvendësuar ata me fjalë të pastra shqipe. Krijimet e tij janë të bukura e korrekte duke iu përmbajtur edhe aspektit stilistik, estetik dhe atij gramatikor. Kadareja ka krijuar një numër shumë të madh të fjalëve të reja, nga të gjitha llojet e krijimeve gjuhësore, si: fjalë të prejardhura, të përbëra, të përngjitura, të nyjëzuara, krijme të përziera etj.

Krijoi aq shumë sa që ata që i mbodhën dhe ende i mbledhin ato, kanë bërë fjalorë dy e tre vëllimesh, e ende gjejmë fjalë që nuk janë të përfshira në këta fjalorë. Në këtë tekst janë sjellë disa nga kompozitat që ne kemi vlerësuar se janë krijime të Kadaresë. Përmes kompozimit, Kadareja ka mundur të shprehë ide dhe koncepte të reja, duke i dhënë mundësi gjuhës shqipe të zhvillohet dhe pasurohet, dhe gjithashtu ka arritur të shprehë ngjyime të ndryshme stilistike me krijimet e tij. Kompozimi në gjuhën shqipe si i tillë ka filluar relativisht vonë të të pasqyrohet në gramatikën e gjuhës shqipe dhe në fjalorët e saj.

Të parët që u morën me këtë çështje ishin studiuesit të huaj, si: *Hahni, Dozoni, Weigandi e ndonjë tjetër. Këto studiues thuajse e mohanin ekzistimin e kompozitave të mirëfillta të shqipes, kurse nga ana tjetër (rryma e dytë), adhuresit dhe dashamirësit e shqipes, duke u mbështetën në gurrën e gjuhës popullore dhanë një pasqyrim hulumtues dhe objektiv për këtë moment të ri gjuhësor. Ndër themeluesit e një tradite të tillë janë: K. Kristoforidhi, A. Xhuvani, K.Cipo, vëllezërit Frashëri e shumë të tjerë*³¹, për të vazhduar më pas me brezin tjetër të studiuesëve e të krijuesëve në gjuhën shqipe, si: Çabej, Kostallari, Thomai, Hysa, Islamaj, Lasgushi, Kadareja, Agolli etj.

Fjalët e përbëra

Fjalë e përbëra apo kompozitë e mirëfilltë në shqipen është bërë ajo fjalë dygjymtyrëshe që formohet nga bashkimi i dy a më shumë temave në një fjalë të vetme, në një njësi të vetme leksiko-semantike strukturalisht të mbyllur, e cila formësohet si një tërësi e pavarur fonetiko-morfologjike, ka kategoritë e veta potenciale fjalëformuese, zhvillohet semantikisht dhe kryen funksionet e veta semantike gjithnjë si një tërësi-fjalë, pavarësisht nga veçoritë fonetike dhe leksiko-gramatikore të komponentëve të saj³². Njëra nga këto (tema mbështetëse, që zakonisht është e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndërsa tema tjetër, (ose , kur janë më shumë se një) është e asnjësuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore³³, p.sh.: te fjala *besëshkelës*, mbaresat trajtëformuese i shtohen fjalës së dytë dhe në bazë të kësaj mund të shohim se kjo fjalë gramatikisht është e gjinisë mashkullore meqë të njëjtën gjini gramatikore ka pjesa e dytë e saj.

³¹ Shkelqim Millaku “Kompozitat në Fjalorin e Gjuhës Shqipe të Mehmet Elezit”(online).

³² *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Tiranë, AShSh, 1972, faqe, 83.

³³ *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, AShSh, 1995, faqe 70.

Kuptimi i fjalës së përbërë mund të jetë i barabartë me kuptimin e fjalëve prej nga rrjedh njësia e re e fituar, por mund edhe mos jete i njëjtë me kuptimin e fjalëve që e kanë formuar atë njësi të re leksikore. Si rezultat i lidhjeve të shumëllojshme, në të cilat hyjnë pjesët e kompozitës, del një njësi e re leksikore që shpreh një nocion të ri, si: *duarthatë* (shih. *duar* + *thatë*), *zëtrashë* (shih. *zë* + *trashë*) etj.

Në gjuhën shqipe ndajshitesimit është mënyra më prodhimtare për krijimin e fjalëve të reja, e pas tij vjen kompozimi i cili gjithashtu është mënyra shumë prodhimtare për pasurimin dhe pastrimin e gjuhës. Fjala e përbërë, e cila ka të paktën dy tema motivuese, thajse gjithmonë kanë temë semantike më të madhe se fjalët nga vjen dhe e paraqesin qartë e në mënyrë më të drejtpërdrejtë nocionin që shprehin, prandaj ato po marrin përhapje të gjerë, sidomos në terminologjinë tekniko-shkencore, ku kërkohet një shprehje sa më e përpiktë dhe njëkohësisht sa më ekonomike e koncepteve. Me anë të kompozimit zakonisht formohen emra e mbiemra dhe një numër i kufizuar foljesh e ndajfoljesh, kurse të pjesët tjera të ligjeratës kompozimi nuk vepron.³⁴

Në formimin e një kompozite marrin pjesë tema fjalësh emërtuese: emra, mbiemra, folje e ndajfolje, si dhe tema numërorësh e përemrash³⁵ dhe në bazë të kësaj mund të bëhet një ndarje e kompozitave duke marrë si parim kategorinë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve përbërëse të kompozitës. Kështu fjalët e përbëra mund të jenë të krijuara nga dy gjymtyra emra (zemërgur), nga një emër dhe një mbiemër (fuqplotë) si dhe nga një numëror dhe një emër (dyluftim). Gjymtyrët e kompozitave në gjuhën shqipe janë gjithnjë dy, kurse temat janë zakonisht dy, por mund edhe më shumë. Kur kemi më shumë se dy tema, dy prej tyre hyjnë në një gjymtyrë të përbërë, ndërsa lidhja që mbizotëron është ajo bashkërenditëse.

Raporti midis kuptimeve të gjymtyrëve dhe kuptimit të fjalës kompozitë varet nga raporti sintaksor midis këtyre gjymtyrëve, që mund të jetë i bashkërenditjes ose i nënrenditjes. Megjithatë, ndarja kryesore dhe ajo që kemi marrë ne parasysht për të analizuar këtë pjesë të fondit të fjalëve të Kadaresë është ndarja sipas lidhjes ndërmjet gjymtyrëve. Sipas saj, kompozitat ndahen në përcaktore dhe këpujore³⁶.

a) *Kompozitat përcaktore përbëhen prej dy gjymtyrësh, nga të cilët njëra përcakton tjetrën, ose e para të dytën*³⁷, si p.sh.: si p.sh.: *baltëdhedhës, bejtethurës, diellkanosje* etj.

b) *Kompozitat këpujore janë fjalë të përbëra prej dy a më shumë gjymtyrësh me lidhje bashkërenditjeje ndërmjet tyre. Ato janë emra*³⁸, si p.sh.: *hyjanjeri, hoxhaprift* etj. Fjalët kompozita me lidhje këpujore janë më të pakta si në fondin e fjalëve të shqipes ashtu edhe në fondin e fjalëve të reja të Kadaresë.

Për kompozitat e shqipes së pari ka shkruar Jokli (sipas referimeve të Çabejt), ndërsa prej gjuhëtarëve shqiptarë do përmendim Cipon, Xhuvanin, Çabejn e Kostallarën. Siç dihet, në gjuhësinë indoevropiane terminologjia e kompozitave ka depërtuar nga indishtja, sepse ajo është mjaft e pasur me to. Të shtojmë se pjesa e parë e kompozitës del e palakuar siç ndodh në mbarë shqipen. Prof. E. Çabej për mrekulli e kishte hetuar se topika e pjesëve të kompozitave të shqipes përkon me ato të gjuhëve të tjera indoevropiane, d.m.th. elementi përcaktues i saj është i dyti dhe jo i pari (vetëm në rasta të rralla mund të ngjajë e kundërta³⁹).

Do të shihet më poshtë se sa shumë e pëlqen Kadareja krijimin e fjalëve të reja me anë të kompozimit nëpërmjet kompozitave të bukura kadareane që i kemi radhitur. Janë kaq të larmishme fjalët, janë po aq befasese kuptimet. Kadareja nuk resht së krijuari emra, mbiemra,

³⁴ Po aty, faqe71.

³⁵ Gramatika e gjuhës shqipe, AShSh. Tiranë 1995, faqe71.

³⁶ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, Botmet Dudaj, 2005, faqe156.

³⁷ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë 1995, faqe72.

³⁸ Po aty, faqe 71.

³⁹ A. Zymbri, faqe. 215

folje, ndajfolje. Në kohën kur mendon se janë shterur mundësitë, na del një fjalë e re, akoma më e bukur dhe më shqip se kurrë. Kadareja shfaqet si një nga letruesit më të mirë të fjalëve kompozita. Ai i krijon ato si për sende a ide të reja, ashtu edhe për qëllime stilistike. Duket sikur i shkon shtatit gjuhës së tij pikërisht kjo mënyrë fjalëformimi. Gjithë fjalët e tij janë pothuajse gramatikisht të goditura. Është i madh numri i tyre, kanë një semantikë dhe një stil të bukur. Ajo që është shumë e rëndësishme është shtegu që tashmë ka hapur Kadareja për krijimin e fjalëve kompozita.

Emra të përbërë me lidhje përcaktore

Më poshtë i kemi rrastuara disa kompozita të bukura kadareane, si:

arkëmort; autokritikan; baltëhedhës; barasrrafshues; bejtethurës; besëshkelës dehashpirt; diellkanosje; dybesims; dyemërsh; dypeizazhshmëri; dyteatërsh; dygrua; dyjetësi; dyfetari; dykahj; dykrishtëri; dymundësi; dyvejshë; dyzanafillë; dhelqpërdashje; erashkëmbajtës; ëndërrçues; ëndërrparës; ëndërrshkoqitës; ëndërrrëfim; fatthënie; fernerdezës; fenershues; fepakë; fjalëkëmbim; fortafolës; fortashtrojë; fundbota; funddëshpërim; funddhjetor; fundgusht; fundjavë; fundvjeshtë; fundshekull; fushavajë; fytyrëqelqët; gazarrenë; gazavaj; gënjimpamje; gojëkyçje; gozhdëngulës; grambulues; garrëmbyes; grykëçjerrë; gjuhëzhdukje; hair-ferman; hakmarrjefantazmë; haremaraba; hënëmarrok; ikonashitës; jetëshkurtësi; kafepirës; kalë-shpend; kandrrambytës; këmishënatë; kryebesëtar; katërfshatars; kryeëndërr; kryeëndërror; kryeteposhtje; kryefalltar; kumtzbërthyes; lafshëprerje; makthparës; makthdërgues; mbretvrasës; meskalim; mestetor; mëmëvrasje; mjekërkohë; modëndjekje; motërvetme; munxadhënës; munxasprapës; naftëhedhës; nënëterezist; ndryshkaheqës; njëgjaks; njoftimshkrues; pragmuzg; prejardhoman; prejardhofob; prillmort; rrobarojë; prindvrasje; setërshqyer; skeptërmbytës; syheqës; syheqje; sykeqojë; syleshtësi; syngrenës; synxjerrës; syvetëm; shkabofili; shkabofobi; shkallanashtatë; shpitkurth; shpitkazmëri; tjetërmendje; total-kalë; trianëfshatar; trifetari; trirrotësh; trutharje; thonjprerës; vakëflënës; vdekjethithës; vetaziatizim; vetëmërgim; vetëpërbaltje; vetëveçim; vëllavogli; yjkuptues; yjpyrës; yllfolës; zëthavënës; zëthaheqës etj.

Emra të përbërë me lidhje përcaktore të cilët si pjesë të parë e kanë fjalën gjysmë:

gjysmankth; gjysmëdremetje; gjysmëdhëmbë; gjysmërrësirë; gjysmëfluturim; gjysmëgazetarë; gjysmëgrua; gjysmëhark; gjysmëndërr; gjysmëheshtje; gjysmëhordhi; gjysmëmagjistar; gjysmëmuzg; gjysmënokdaun; gjysmore; gjysmëroman; gjysmërrënë; gjysmësovran; gjysmëshëronjës; gjysmëtang; gjysmëterr; gjysmëvdekje; gjysmëzot etj.

Emra të përbërë me lidhje këputore

gruavajzë; hoxhaprift; hyjanjeri; jetëvdekje, ngazëllimotmerr; vdekjejetë; zidasmë etj.

Mbiemra të përbërë

a) të panyjshëm:

besëprerës; besëthyes; biografibukura; birvrasës; bisedëvrasës; bjerramendës; botëpushtues; bythëbutë; bythëpambuks; dyemërsh; dypresash; dyshtetës; festëprishës; festivo-bashkueso-harrues; fjalëgjysmuar; flatrashpejtë; flegrahekurt; flokëçeltë; hënëzbathur; kobndjellës; kokëlakër; kombvrasës; krimbdëgjuese; sqimëshumë; shumëmerësh; tmerrndjellës; triharkësh; ziplotë; vetëfajsues, gjymtyrëgjatë, gjumëprishës, vetëflijes etj.

a) Mbiemra të përbërë të cilët si pjesë të parë e kanë fjalën gjysmë-

gjysmasnjënës; gjysmatank-gjysmabunker; gjysmaziatik; gjysëmborgjez; gjysmëfushor; gjysmëfamiljar; gjysmëironik; gjysmëmagjistar; gjysmëpërqeshës; gjysmëpërrallor;

gjysmëqesharak; gjysmëqellor; gjysmërinor; gjysmëshëronjës; gjysmëshkrimtar; gjysmëshpërfillësh; gjysmëshpotitës, gjysmëmallës; gjysmëtrillan; gjysmëtullac etj.

b) të nyjshëm:

baraspërlyer (i,e); disaditsh/ëm-me (i,e); dokohsh/ëm-me (i,e); kësojetsh/ëm-me (i,e); kësosisojsh/ëm-me (i,e); kësodorsh/ëm-me (i,e); mirakeq (i,e); sapobuthtuar (i,e) etj.

Mbiemra të përbërë + prapashtesë, si:

baraspeshtë (i,e); dyjetsh/ëm-me (i,e); fundbotsh/ëm-me (i,e); fundjetsh/ëm-me (i,e); gjithgjendsh/ëm-me (i,e); gjithpranish/ëm-me (i,e); hijedritsh/ëm-me (i,e); jashtarsyesh/ëm-me (i,e); jashtëkohsh/ëm-me (i,e); jashtudhsh/ëm-me (i,e); këtëhersh/ëm-me (i,e); njëkahsh/ëm-me (i,e); tjetërbotsh/ëm-me (i,e); trupshpirtsh/ëm-me (i,e); vdekjejetsh/ëm-me (i,e); krejtkotsh/ëm-me (i,e); krejtrroksh/ëm-me (i,e); skajjetsh/ëm-me (i,e); mirëkuptuesh/ëm-me (i,e), dymotëror; dypërmasësh; pesëqindkrerësh; rrokarmëse etj.

Përfundimi

Në këtë tekst u përpoqëm që të bejmë analizën e disa nga fjalët e shumëta të përbëra që gjenden në veprat e shkrimtarit tonë të madh, Ismail Kadare. Vepra e Kadaresë, e njohur për mjeshtërinë e shkrimit, ka pasuruar gjuhën shqipe me shumë fjalë të reja, duke i dhënë asaj një shkallë më të lartë letrare, duke e ngritur në një nivel që nuk ka qenë kurrë më parë. Ai ka krijuar dhe përdorur kompozita të ndryshme, si dhe ka kontribuar në pastrimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe duke e pasur për synim rikthimin e fjalëve të moçme të shqipes dhe përdorimin e atyre dialektore e krahinore nga gjithë shqipfolësit e jo vetëm.

Në punim, janë analizuar kompozitat e ndryshme të Kadaresë, duke u fokusuar në atë se si këto fjalë janë të ndara sipas llojit të lidhjes ndërmjet gjymtyrëve të kompozitës: kompozita përcaktore dhe këpujore. Nga vetë emërtimi i tyre, fjalë të përbëra përcaktore janë ato që në vete kanë dy gjymtyrë, ku njëra e përcakton tjetrën, ndërsa kompozitat këpujore janë ato fjalë që lidhin gjymtyra të barabarta. Në pjesën kryesore të punimit janë përfshirë një sërë shembujsh të këtyre kompozitave, si: *baltëhedhës, besëshkelës, diellkanosje* dhe shumë të tjera.

Teksti përfshin një numër shumë të vogël të fjalëve të përbëra që hasen në veprat e Kadaresë. Numri i tyre është shumë i madh. Për fjalët kadareane janë hartuar fjalorë të tërë me disa vëllime, dhe përsëri ka ende për t'u hulumtuar në gjuhën e veprave të tij. Teksti ynë është një gur i vogël i hedhur në kalanë e quajtur Kadareada. Viti që lëmë pas na e mori shkrimtarin tonë, por Kadareja na ka lënë shumë punë me veprat e tij dhe për veprat e tij.

Referencat

- [1]. VEPRA, vëllimi i parë, Paris, 1993.
- [2]. VEPRA, vëllimi i dytë, Paris, 1994.
- [3]. VEPRA, vëllimi i tretë, Paris, 1995.
- [4]. VEPRA, vëllimi i katër, Paris, 1996.
- [5]. VEPRA, vëllimi i pestë, Paris, 1997.
- [6]. VEPRA, vëllimi i gjashtë, Paris, 1998.
- [7]. VEPRA, vëllimi i shtatë, Paris, 1999.
- [8]. VEPRA, vëllimin i tetë, Paris, 2000.
- [9]. VEPRA, vëllimi i nëntë, Paris, 2001.
- [10]. *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1972.
- [11]. Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Prishtinë, 1978.
- [12]. Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Dudaj, 2005.
- [13]. Thomai, Jani. *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*. Tiranë: AShSh, 2001.
- [14]. Thomai, Jani. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe*. Tirane, Botimet Dudaj.

- [15]. Thomai, Jani. *Teksti dhe gjuha*. Tiranë: Botimet Dudaj, 1992.
- [16]. Thomai, Jani. *Veçoritë leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe*. Tiranë: AShSh, 2004.
- [17]. Xhuvani, Aleksandër dhe Eqrem Çabej. *Prapashtesat në gjuhën shqipe*. Tiranë, 1962.
- [18]. *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Tiranë, 1995.
- [19]. Zymberi, Abdullah e të tjerë. *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe (morfologjia)*. Prishtinë.